RAPORT PËRFUNDIMTAR

MBI

(Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë)

"Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të mesme, në varësi të Bashkisë Tiranë"

Tiranë, Qershor 2019

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **4**

II. HYRJA **6**

III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT **8**

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET **18**

V. OPINIONI I AUDITIMIT 43

VI.REKOMANDIMET **45**

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
DKSHM	Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme, në varësi të Bashkisë Tiranë, në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1268/2 prot, datë 18.12.2018, Pika D, protokolluar në subjekt me nr. 66, datë 18.01.2019, me afat auditimi nga data 19.12.2018 deri në datën 16.04.2019, për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2018.

Auditimi u krye për pasqyrat financiare të vitit 2018 si dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare, mbi bazë materialiteti dhe vlerësim risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 "Për vetëqeverisjen vendore", zbatimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 2016-2018. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre.

Në përfundim nga grupi i auditimit, është formuluar një opinion i kualifikuar me theksim të disa pasaktësive të cilat ngelen për tu sistemuar në të ardhmen nga Drejtoria e Financës së subjektit të audituar.

DKSHM, si njësi e varësisë, nuk disponon udhëzime nga Bashkia Tiranë mbi strukturën e raportimit përsa i përket konsolidimit të pasqyrave financiare të bashkisë, raporton në bashki pasqyrat financiare njësoj si në degën e thesarit. Ka kryer periodikisht dhe në fund të vitit rakordimet me thesarin dhe nuk janë evidentuar mospërputhje. Nga evidentimi dhe veridikimi i detyrimeve që likuidohen në vitin 2019 rezulton se janë kontabilizuar si detyrime në PF të vitit 2018 në shumën 6,088,062 lekë nga të cilat 4,372,621 lekë llogaria 600; 1,453,164 lekë llogaria 601; 249,260 detyrime taksa tatime dhe 13,017 lekë detyrime përmbarimore. Nuk rezulton borxh nga të tretët, nuk ka përfituar fonde nga institucione të treta si FZHR. Si të gjitha njësitë buxhetore ka shtrirë efektet në këtë njësi bllokimi i fondeve nga MF në fund të vitit ku përparësi i është dhënë pagave, sigurimeve shëndetësore e shoqërore dhe energjisë elektrike. Evidentohet se nuk ka asnjë vendim gjyqësor të formës së prerë të palikuiduar. Detyrimet e mbartura për vendimet gjyqësore për vitin 2019 rezultojnë në shbumën 640,000 lekë. Ka përfunduar inventarizimi i aktiveve për vitin 2018, janë llogaritur e reflektuar amortizimet, nuk ka nxjerrje jashtë përdorimit. Gjatë vitit 2018 janë bërë dy alokime fondesh të miratuara në KB, një shtesë për llogaritë 600, 601, 602 dhe 606 dhe një pakësim në llogarinë 600.

Për vitin 2018, nga Drejtoria e Finacës, nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarëse sipas procedurave të prokurimit. Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël", Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme. Kontratat e lidhura regjistrohen te gjitha ne vlera te plota dhe brenda afateve dhe ska patur vonesa. Jo gjithmone ne system ka patur fonde te celura ne momentin e lidhjes se kontrates duke qene se është intitucion ne varesi te Bashkise Tirane dhe sidomos kontratat e lidhura per investimet (art 231) behet kerkesa per celje fondi ne bashki pas lidhjes se kontrates. Kontratat shumevjecare janë obliguar ne thesar te detajuara sipas parashikimit per cdo vit. Shuma e shpenzimeve te ndodhura ne vitin 2018 te papaguara, perfshire energjine elektrike, posta, shpenzime gjyqesore, si edhe fatura te ndryshme eshte 3,775,728 lekë, e cila është raportuar në thesar në klasën 4(llogaria 486).

- Për vitin 2018, nga Drejtoria e Finacës, nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarëse sipas procedurave të prokurimit si dhe nuk janë kontabilizuar detyrimet për shpenzimet e pa paguara të faturave të mbritura.

Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël", Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme.

Nga verifikimi rezultoi se në *Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme*, <u>për vitin 2016</u>, janë zhvilluar gjithsej 17 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 24,754,371 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 21,956,872 lekë, duke kursyer shumën prej 2,797,499 lekë ose në masën 11% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-"Blerje me vlerë të vogël", 8 procedura, me fondin limit në total prej 2,408,991 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,944,180 lekë, duke kursyer shumën prej 464,811 lekë;

-"Kërkesë për propozim", 5 procedura, me fondin limit në total prej 13,714,499 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 12,928,782 lekë, duke kursyer shumën prej 785,717 lekë.

-"Tender i Hapur", 4 procedura, me fondin limit në total prej 8,630,881 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 7,083,910 lekë, duke kursyer shumën prej 1,546,971 lekë.

Gjithashtu janë zhvilluar 8 procedura prokurimi jashtë sistemit elektronik të APP të llojit "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", me fondin limit në total prej 4,815,647 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 4,803,480 lekë, duke kursyer shumën prej 12,167 lekë.

<u>Për vitin 2017</u>, janë zhvilluar gjithsej 14 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 23,272,097 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 20,706,045 lekë, duke kursyer shumën prej 2,566,052 lekë ose në masën 11% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-"Blerje me vlerë të vogël", 6 procedura, me fondin limit në total prej 1,957,703 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,632,479 lekë, duke kursyer shumën prej 325,224 lekë;

-"Kërkesë për propozim", 5 procedura, me fondin limit në total prej 16,025,785 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 14,855,566 lekë, duke kursyer shumën prej 1,170,219 lekë.

-"Tender i Hapur", 3 procedura, me fondin limit në total prej 5,288,609 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 4,218,000 lekë, duke kursyer shumën prej 1,070,609 lekë.

Gjithashtu janë zhvilluar 5 procedura prokurimi jashtë sistemit elektronik të APP të llojit "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", me fondin limit në total prej 4,668,902 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 4,525,250 lekë, duke kursyer shumën prej 97 lekë.

<u>Për vitin 2018</u>, janë zhvilluar gjithsej 15 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 23,692,364 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 20,645,158 lekë, duke kursyer shumën prej 3,047,206 lekë ose në masën 13% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-“Blerje me vlerë të vogël”, 6 procedura, me fondin limit në total prej 1,465,517 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,215,920 lekë, duke kursyer shumën prej 249,597 lekë;

-“Kërkesë për propozim”, 5 procedura, me fondin limit në total prej 14,050,229 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 12,913,613 lekë, duke kursyer shumën prej 1,136,616 lekë.

-”Tender i Hapur”, 3 procedura, me fondin limit në total prej 7,068,175 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 5,421,165 lekë, duke kursyer shumën prej 1,647,010 lekë.

-“Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”, 1 procedurë, me fondin limit në total prej 1,108,443 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,094,460 lekë, duke kursyer shumën prej 13,983 lekë.

Gjithashtu janë zhvilluar 8 procedura prokurimi jashtë sistemit elektronik të APP të llojit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, me fondin limit në total prej 6,244,175 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 6,209,481 lekë, duke kursyer shumën prej 34,694 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1268/2, datë 18.12.2018, Pika D. miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.12.2018 deri në datë 16.04.2019, në subjektin DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë, për periudhën nga 01.01.2016 deri në 31.12.2018, u krye auditimi “Auditim financiar dhe përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. Th., Përgjegjës Grupi
2. B. M., Auditues
3. I. Sh., Auditues
4. J. L., Auditues
5. G. H., Auditues
6. A. Gj., Auditues
7. Ing. S. M., Auditues

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie në DKSHM, Bashkia Tiranë.

Marrësi: DKSHM, Bashkia Tiranë

Procedura e ndjekur*:* Projekt Raport auditimi i dërgohet subjektit DKSHM, Bashkia Tiranë, pasi nga grupi i auditimit janë dorëzuar në protokoll aktet e mbajtura në lidhje me problematikat e konstatuara dhe nga subjekti me shkresat përcjellëse janë paraqitur kundërshtitë, të cilat pasi janë analizuar me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore, ndërsa për rastet e tjera të cilat kundërshtitë nuk mbështeteshin me argumente ligjore, nuk janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar në këtë projekt raport auditimi, i cili, pas respektimit të afatit ligjor, është kthyer në KLSH me shkresën nr. 1268/10, datë 25.06.2019 dhe, mbi bazën e të cilit është përgatitur ky raport përfundimtar auditimi.

Objektivat dhe qëllimi: Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të DKSHM në varësi të Bashkisë Tiranë për vitin 2018 dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit*:*

- ***Qëllimi i auditimit:***

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit financiar dhe përputhshmërisë apo hartimi i Projekt Raport auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

- ***Objektivat e auditimit*** synojnë***:***

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullave dhe ligjeve të kontabilitetit;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Identifikimi i çështjes:

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit*)*.

Strukturat drejtuese të DKSHM në varësi të Bashkisë Tiranë janë përgjegjëse për paraqtijen e drejtë të pasqyrave finaciare në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe në të njejtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të DKSHM në përputhje me kriteret e përputhsmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të aparatit të DKSHM dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin, menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Kriteret e vlerësimit. Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

✓ Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; i ndryshuar

✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

✓ Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "*Për buxhetin e vitit 2017*", ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 "*Për buxhetin e vitit 2018"* dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje.

✓ Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* i ndryshuar,

✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, etj.
✓ UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor...",* i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
✓ MF nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.
✓ Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 "Për miratimin e manualit të MFK".

Standardet e auditimit Auditimi është kryer sipas standarteve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.

 ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

 ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë"* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me
kontekstin specifik te auditimit të përputhshmërisë;

 ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200;

 Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;

 Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

 Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm: Auditimi në DKSHM në varësi të Bashkisë Tiranë u krye në kuadër të planifikimit sipas pikës D. të programit të auditimit duke u përzgjedhur si subjekt në varësi të Bashkisë Tiranë në bazë të vlerësimit të riskut dhe në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Bashkisë Tiranë. Në këtë subjekt, u evidentuan të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve. Ky auditim ka rëndësi për KLSH duke qenë se është njësi në varësi të Bashkisë Tiranë si njësia më e madhe e vetëqeverisjes vendore.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky projekt raporti Auditimi.

***Parimet e auditimit financiar*:** Në punën tonë audituesve jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

***Përkatësia*:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
***Plotësia*:** Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
***Saktësia*:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.
***Periudha*:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.
***Klasifikimi*:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
***Ligjshmëria dhe rregullsia*:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.
Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës
***Ekzistenca*:** asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.
***Të drejtat dhe detyrimet*:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.
***Plotësia*:** Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
***Vlerësimi dhe alokimi*:** Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.
Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese
***Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet*:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
***Plotësia*:** Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
***Klasifikimi dhe kuptueshmëria*:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
***Saktësia dhe vlerësimi*:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.
Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialiteti në përputhje me **ISSAI 1320** dhe **ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesit konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialiteti janë marrë shpenzimet. Pas përcaktimit të nivelit të materialiteti grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri të moderuar.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimit përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut të KLSH.
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.
Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh krahasimet mes

buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne letër ose elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit*:*

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

Objekti i këtij auditimi është raportimi financiar dhe paraqitja e drejtë dhe e sinqertë e pasqyrave financiare për vite 2018. Gjithashtu, sipas programit të auditimit, objekt i këtij auditimi është edhe vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit të audituar me kriteret e vlerësimit.

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit për pasqyrat financiare dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me aktivitetin dhe operacionet për efekt të ligjit të prokurimit dhe mnaxhimit financiar dhe kontrollit.

Fushëveprimi i këtij auditimi përfshin të gjithë aktivitetin e DKSHM, Bashkia Tiranë. Në këtë mënyrë nuk është vlerësuar raportimi në pasqyrat financiare përsa i përket konsolidimit

si pasojë e kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për vitin 2018 pasi, gjatë ushtrimit të auditimit në terren, konsolidimi ishte në proces dhe brenda afateve të përcaktuara.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të DKSHM, Bashkia Tiranë.
Misioni për njësinë që auditohet është Kryerja e funksioneve të veta duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet financiare (*grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i bashkisë me synim ofrimin e shërbimeve të caktuara për DKSHM, Bashkia Tiranë).*
Objektivat burojnë nga ligji "Për vetëqeverisjen vendore" dhe strategjitë e zhvillimit të Bashkisë Tiranë.
Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të aktivitetit, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

I.b. "Përmbledhje e gjetjeve kryesore"

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
1	Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe celjen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyn pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.		**I mesëm**	Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentintin e nënshkrimit të tyre.
2	Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dh monitorimit të buxhetit u konstatua se: -Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj. -Nëpunësi autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, në Bashki raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, aktivitetet dhe objektivat e realizuara për çdo projekt, të përcaktuara në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm", nga ku konstatojmë se ka mangësi për sa i takon analizës së aktiviteteve në bazë produktesh për cdo program.		**I mesëm**	Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për cdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mosefektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë riskuar dhe nxitur shkurtimin e morealizimin shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përllogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimin e tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.			fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim efiçent të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal. Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i "shkaktojnë" këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Të rritet përformanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të marrë veprimet e duhura korrigjuese për të përmirësuar situatën dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet.
3	Funksionimi i kontrolleve të vendosura reflekton mangësi nga testimi i përgjigjeve me shkrim të strukturave drejtuese me përgjigjet e pyetësorëve në disa rubrika. Raportohet se strukturat drejtuese janë përfshirë në vendimmarrje në masën 100% të të intervistuarve; kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme rreth 80% e të intervistuarve; janë njohur me strategjitë e njësisë për periudhën 2018-2022 rreth 100% e të intervistuarve nga të cilët 80% raportojnë se strategjia është reflektuar tek buxheti vjetor, 20% tek plani strategjik; në procesin e rekrutimit janë përfshirë 100% e drejtuesve dhe, pyetjes "Në cilën pjesë të analizës SËOT gjatë vitit 2018 keni kontribuar?" asnjë nuk ka qenë pjesë e analizës. Raportohet gjithashtu nga niveli i mesëm specialist se kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018 vetëm 33% e të intervistuarve dhe, pyetjes "A jeni njohur me strategjinë për vitin 2018?" raportojnë pozitivisht 95% e të intervistuarve. Gjithashtu pyetjes "Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018?" raportojnë 81% tek përshkimi i punës për cdo vend pune dhe 19% tek plani strategjik.		**I mesëm**	Drejtori i DKSHM të marrë masa me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.
4	<u>1-Në dokumantacionin e administruar në dosjen e sistemit të prokurimit elektronik në APP (Ref.11-392) për procedurën me objekt;" Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme"</u> u konstatuan mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi konkretishtë; -Nëpërmjet njoftimit të fituesit datë 09.06.2017 konstatohet se, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE "K." shpk me vlerë 3.546.200 lekë pa tvsh, ndërsa nuk ka kualifikuar ofertën e paraqitur nga OE "L."shpk me vlerë 3.165.600 lekë pa tvsh, vlerë kjo më e ulët se vlera e ofertës e shpallur fituese me diferencë shuma 380,600 lekë pa tvsh me argumentin		**I lartë**	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eleminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST dhe konsiderimin në mënyrë strikte të mospërputhjeve të cilat mund të konsiderohen si në shkallë të tillë materialiteti që nuk cenojnë zbatimin e kontratës duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike..

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	se: kjo ofertë nuk ka plotësuar"Kritere të vecanta për kualifikim", pika 1.3 "Kapaciteti Teknik", ku me analizë evidentohet **sa më poshtë;** a-pikën 1.3;-"OE per te gjitha mjetet e deklaruara ne dokumentat e tenderit ne funksion të realizimit të kontratës nuk ka paraqitur çertifikatën e pronësisë së këtyre mjeteve, duke mos përmbushur kriteret e vecanta per kualifikim pika 1.3, Kapaciteti teknik ku specifikisht kërkohet nga autoriteti kontraktor: Ofertuesi duhet te ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjete transporti te vlefshme per gjithe periudhen e zbatimit te kontratës për furnizimin e ushqimeve blegtorale, si me poshte: Automjet te pershtatshem (frigoriferik ATV) per artikujt e bulmet e mish (2 cope). Per automjetet te paraqitet certifika pronesise, kontrata e dhurimit apo qirase sipas rastit dhe dokumentacioni perkates, Certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe Siguracion te automjeteve ne dispozicion si dhe leje per transport mallrash. (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshmëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi). -"Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2, gërma "ç", përcaktohet se:"Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:[…] e.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri". Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", përcaktohet shprehimisht që: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar." Nisur nga sa me siper Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "L." sh.p.k. nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kërkesa për pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike nuk plotësohet. Konkretisht, rezulton se operatori ekonomik "L." nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se shoqëria "L." sh.p.k rezulton të ketë të papaguar faturën e muajit Mars 2017. Lidhur me këtë fakt, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjykon se operatori ekonomik "L." shpk nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi procedura e prokurimit është publikuar në datën 08.05.2017, dhe			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	hapja e ofertave është zhvilluar në datën 05.06.2017, kohë në të cilën operatori ekonomik në fjalë kishte mundësinë e likujdimit të faturës së energjisë elektrike për muajin Mars 2017 në mënyrë që të përmbushte kriteret për kualifikim. Operatori ekonomik "L." shpk, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, nuk ka vërtetuar se ka shlyer të gjitha detyrimet e matuara të energjisë elektrike, përfshirë edhe detyrimet për muajin Mars 2017, data maksimale përfundimtare për shlyerjen e të cilit, mbështetur në nenin e sipërcituar, ishte data 30.04.2017. Në Vendimi ERE nr.109, datë 21.10.2011 përcaktohet se: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore..... jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar."cka do të thotë se afati 30.04.2017 është dita e fundit për shlyerjen e këtij detyrimi. Ofertuesit e mundshëm dhe në rastin konkret shoqëria "L." e cila shpreh interesin për të marrë pjesë në këtë procedurë kishte kohë të mjaftueshme për likujdimin e detyrimit për muajin Mars 2017. pasi detyrimi nuk mund të shlyhet pas datës 30.04.2017". -"Per kompleks stallor paraqitur OE "L."shpk ka paraqitur dokumentacionin sa me poshte vijon: Është paraqitur kontrata me shoqerine "F."shpk e cila nuk eshte me kontrate noteriale sic është kërkuar në kriteret e vecanta per kualifikim kapaciteti teknik. Gjithashtu ne lidhje me kete kontrate nuk eshte paraqitur leje mjedisore e tipit C kategoria III.1.A "Per therrtore" sic eshte kerkuar ne kriteret e vecanta per kualifikim por leje mjedisore me kategorine III.1.B "Per mbareshtim te kafsheve te gjalla" duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim Kapaciteti Teknik. Gjithashtu Akti miratimit nuk eshte per leje mjedisore te tipit C me objekt "Therrtore" por per leje mjedisore me objekt "Per mbareshtim lopesh per prodhim qumeshti" duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim. Per therrtoren nuk eshte paraqitur planimetria dhe gjurma ne harten rajonale duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik. Ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik "L." shpk ka paraqitur nje kontrate me shoqerine "K." ku i gjithe dokumentacioni bashkengjitur kontrates eshte teresisht i paqarte dhe i palexueshem, duke u bere i pamundur identifikimi i te dhenave te tij dhe verifikimi i tyre nese jane ne perputhje me kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit me qellim krijimin e nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesive te operatorit ekonomik per permbushjen me sukses te kontrates., Sa më sipër, sqarojmë se është detyrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik për paraqitjen dhe hedhjen e			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	dokumentacionit të plotë, të saktë e të qartë për nga mënyra e leximit dhe identifikimit të të dhënave të tij, në mënyrë që të jetë i lexueshëm dhe për të verifikuar nëse ai është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "L."shpk per kontraten e paraqitur me shoqerine "K." nuk mund te konsiderohet i vlefshem". Sa më sipër në të dy kontratat e paraqitura në plotësim të këtij kriteri për thertore nuk plotësojne kriteret e percaktuara nga AK në DST. Nga auditimi dokumentacionit i administruar në dosjen e procedurës e pasqyruar në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se; oferta me vlerë më të ulët e konsideruar e pavlerësuar drejtësisht e vlerësojmë se kërkesat kualifikuese të dorëzuara nga ky OE janë të plotësuara dhe KVO-ja gjatë shqyrtimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit "oferta më e ulët" në procesin e vlerësimit duhej të kishte qënë më fleksibël për të kualifikuar edhe ofertën e dorëzuar nga OE "L." shpk me vlerë 3.165.600 lekë pa tvsh, si ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme dhe dokumentat e paraqitura në konkurim nuk kanë sjell asnjë deformim të ofertës, në përmbushje të detyrimeve të parashikuar nga neni 53 pika 1, ku citohet qartësishtë; "Autoriteti kontraktor kur e shikon të arsyeshme u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 e 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme"dhe neni 54 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pasi mangësitë e pa analizuara në vlerësimin e ofertës, pa cilësuar dhe pa cënuar thelbin e ofertës të parashikuara në LPP, ndërsa KVO-ja duhej të ishte kërkuar arsyetim me informacion shtesë nga ky OE konkurues me ofertë ekonomike më favorizuese sepse; -për pikën 2, gërma (ç); "..konstatohet se për shlyerjen e detyrimit të energjisë është kërkuar vetëm; (Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri).....", ndërsa KVO ka kërkuar jashtë kësaj kërkese përfshirjen e muajit mars 2017, por ky komision mban 2 qëndrime të ndryshme për të njëjtën kërkesë kualifikuese, sepse oferta e paraqitur nga OE konkurues "G." shpk me vertëtimin e energjisë nr.307, datë 12.04.2017 është kualifikuar, ndërkohë që ka të njëtjën përmbajtje dhe datë"..., për pasojë oferta me këtë dokunement i dorëzuar në			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	konkurim plotëson kërkesën kualifikuese. -për pikën 1.3;"..konstatohet se, dokumentacioni për kompleksi stallor është paraqitur kontrata me shoqerine "F."shpk e cila është kontratë me vulë të njomë të zyrës noteriale....", për pasojë oferta me këtë dokunement i dorëzuar në konkurim plotëson kërkesën kualifikuese. -për pikën 1.3; ".....është e vërtet që dokumetacioni i objektit thertore është në kushtet e pa dukshme dhe për objektin tjetër thertore është e paisur me leje III.1.B, por është i paisur më leje nga Inspektoriati shtetror shëndëtsor, njëkohësisht referuar në Shtojca 19 Sasia dhe grafiku i lëvrimit ku sasia e mishit për tu furnizuar është vetëm 900 kg, kërkesa për kualifikuese që OE të ketë në pronësi apo me qera një objekt thertore me sipërfaqe jo më të vogël se 150 m2 është kërkesë e pa argumentuar.....", për pasojë kjo kërkesë duhet të konsiderohet devijim i vogël duje kërkuar edhe informacion shtesë për vlerësimin e kërkesës kualifikuese. Në këto kushte vlerësimi bërë nga KVO për shpalljen e ofertës fituese, është në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", neni 20 "Mosdiskriminimi", neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", neni 52 "Hapja e ofertave" pika (1); (6), neni 53 "Shqyrtimi i ofetave", pika (1); neni 54 "Alternativat", neni 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu (VII) "Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave"; neni 64 "Hapja e ofertave"; neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"; neni 67 "Klasifikimi i ofertave"; neni 68 "Raporti përmbledhës"; neni 74 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pasi ka skualifikuar ofertën me vlerë më të ulët e cila plotëson kriteret për kualifikim, për pasojë vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertës fituese me vlerë 3.546.200 lekë pa tvsh me diferencë më tepër shuma 380,600 lekë pa tvsh (3546200-3165600) përbën efekt negativ finaciar për buxhetin Bashkia Tiranë duke mos siguruar efektivitetin e fondeve në shumën 380,600 lekë pa tvsh. 2-Në dokumantacionin e administruar në dosjen e sistemit të prokurimit elektronik në APP (Ref.57-002) për procedurën me objekt;" Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme" u konstatuan mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi konkretishtë; -Nëpërmjet njoftimit të fituesit datë 04.04.2018 konstatohet se, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE "K."shpk me vlerë 4,668,050 lekë pa tvsh, ndërsa nuk ka kualifikuar ofertën e paraqitur nga OE "L."shpk me vlerë 3,986,300 leke pa tvsh,			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	njëkohësishtë edhe ofertën e paraqitur nga OE "D."shpk me vlerë 4,003,900 lekë pa tvsh edhe kjo vlera më e ulët se oferta e shpallur fituese me diferencë shuma 664,150 lekë pa tvsh. Nga auditimi dokumentacionit i administruar në dosjen e procedurës e pasqyruar në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se për këtë ofertë me vlerë më të ulët, KVO nuk e ka konsideruar në njoftimin dhe shpalljen e fituesit dhe nuk e ka shqyrtuar dhe vlerësuar me kërkesat kualifikuese të dorëzuara, ndërsa nga verifikimi i dokumentave të OE "D."shpk janë të plotësuara dhe KVO-ja gjatë shqyrtimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LPP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit "oferta më e ulët" në procesin e vlerësimit duhej të kishte qënë më fleksibël për të kualifikuar edhe ofertën e dorëzuar nga OE "D."shpk me vlerë 4,003,900 lekë pa tvsh, si ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme dhe dokumentat e paraqitura në konkurim nuk kanë sjell asnjë deformim të ofertës, në përmbushje të detyrimeve të parashikuar nga neni 53 pika 1, ku citohet qartësishtë; "Autoriteti kontraktor kur e shikon të arsyeshme u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 e 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme"dhe neni 54 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pasi mangësitë e pa analizuara në vlerësimin e ofertës, pa cilësuar dhe pa cënuar thelbin e ofertës të parashikuara në LPP, ndërsa KVO-ja duhej të ishte kërkuar arsyetim me informacion shtesë nga ky OE konkurues me ofertë ekonomike më favorizuese. Në këto kushte vlerësimi bërë nga KVO për shpalljen e ofertës fituese, është në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", neni 20 "Mosdiskriminimi", neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", neni 52 "Hapja e ofertave" pika (1); (6), neni 53 "Shqyrtimi i ofetave", pika (1); neni 54 "Alternativat", neni 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu (VII) "Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave"; neni 64 "Hapja e ofertave"; neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"; neni 67 "Klasifikimi i ofertave"; neni 68 "Raporti përmbledhës"; neni 74 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pasi ka skualifikuar ofertën me vlerë më të ulët e cila plotëson kriteret për kualifikim, për pasojë vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertës fituese me vlerë 4,668,050 lekë pa tvsh me diferencë më tepër shuma 664,150 lekë pa tvsh(4668050-4003900) përbën efekt negativ finaciar për buxhetin e Bashkisë Tiranë duke mos siguruar efektivitetin e fondeve në shumën 664,150 lekë pa			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	tvsh.			
5	Nga auditimi i evidencës së grumbulluar rezulton se veprimtaria e DKSHM për vitin 2018 është orientuar kryesisht nga përcaktimet në buxhetin vjetor dhe PBA. DKSHM nuk ka hartuar e miratuar strategji zhvillimi apo plane strategjike zhvillimore. Në këto kushte dhe për faktin që projektbuxhetimi është skematik në bazë të kërkesave të Bashkisë Tiranë gjatë fazës së përgatitjes së PBA rezulton se nuk dokumentohen objektiva strategjik apo prioritar dhe plane respektive aktivitetesh për zbatimin e tyre. Në mungesë të objektivave të përcaktuara nuk ka sens dhe nuk është përpiluar regjistri i riskut për menaxhimin e risqeve që mund të cënojnë realizimin e objektivave si dhe nuk konceptuar e miratuar gjurma e auditimit.		**I mesëm**	Drejtori i DKSHM të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, të bëjë vlerësimin e situatës aktuale dhe nën këndvështruimin e strategjisë së Bashkisë Tiranë 2018-2022 të ndërtojë strategjitë afatmesme dhe ato vjetore të zbërthyer në plan aktivitetesh duke specifikuar qartësisht dhe në mënyrë koncize objektivat prioritar të DKSHM.

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET

PLANIFIKIMI DHE IDENTIFIKIMI I RISKUT; STRATEGJIA DHE VLERËSIMI I RISKUT; EKZEKUTIMI I PROCEDURAVE TË TESTIMIT; PËRGATITJA E DOKUMENTEVE STANDARDE TË AUDITIMIT DHE KOMUNIKIMI I TYRE NË MËNYRË TË VAZHDUESHME ME SUBJEKTIN E AUDITUAR.

Në zbatim të pikës C, të programit të auditimit "Nr. 1268/2 datë 18/12/2018", dhe pikës A, 1,2,3, u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:

-Rregulloret e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Njësisë.

-Informacione me shkrim nga drejtuesit e nivelit të lartë mbi veprimtarinë e sektorëve që mbulojnë si dhe objektivat e planet periodike të punës.

-Projektbuxhetet dhe buxhetet vjetore të miratuara.

-Raportet periodike mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Vendime të Këshillit Bashkiak, 2018.

-Intervista dhe raporte me shkrim të punonjësve të administratës.

Objekti është vlerësimi si janë vendosur, përmbushur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nëpërmjet veprimtarive efektive, eficencë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve. Gjithashtu objekt i verifikimit është njohja e subjektit dhe mjedisit ku operon si dhe vendosja dhe kontrolli i funksionimit të kontrolleve me karakter organizativ, ndarja e detyrave, fizik, personeli, mikëqyrja dhe menaxhimi.

Për qëllim të auditimit sa më sipër u përdorën teknika auditimi për grumbullimin e evidencës dhe auditimin si fizike, dokumentare, verbale dhe analitike.

Nga auditimi i evidencës së grumbulluar rezulton se veprimtaria e DKSHM për vitin 2018 është orientuar kryesisht nga përcaktimet në buxhetin vjetor dhe PBA. DKSHM nuk ka hartuar e miratuar strategji zhvillimi apo plane strategjike zhvillimore. Në këto kushte dhe për faktin që projektbuxhetimi është skematik në bazë të kërkesave të Bashkisë Tiranë gjatë fazës së përgatitjes së PBA rezulton se nuk dokumentohen objektiva strategjik apo prioritar dhe plane respektive aktivitetesh për zbatimin e tyre. Në mungesë të objektivave të përcaktuara nuk ka sens dhe nuk është përpiluar regjistri i riskut për menaxhimin e risqeve që mund të cënojnë realizimin e objektivave si dhe nuk konceptuar e miratuar gjurma e auditimit.

Për të verifikuar funksionimin e kontrolleve të vendosura, të raportuara nga komunikimi me grupin e auditimit, për qëllim të auditimit u kërkua me shkrim 4 drejtorive informacion të shoqëruar me dokumentacion për çështjet e mëposhtme:

"Mbështetur në Programin e Auditimit nr. 1268/2, datë 18.12.2018, protokolluar në DKSHM me nr. 66, datë 18.01.2019, drejtimi i auditimit II,a/3 kërkojmë të vini në dispozicion të Grupit të Auditimit, brenda datës 19.02.2019, dokumente dhe informacione mbi:

1. Mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që Ju drejtoni dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional.

2. Objektivat dhe Prioritetet e funksionit që ju ushtroni për vitin 2018.

3. Risqet e identifikuara në punën tuaj për vitin 2018 dhe vlerësimin, kontrollin e risqeve që mund të kenë vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që Ju drejtoni.

4. Komtributi juaj në garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që Ju drejtoni, bazuar në rregullat e vendosura nga Titullari i Institucionit, si dhe raportet tuaja periodike tek nëpunësi autorizues për çdo dobësi të sistemit. Raportet periodike mbi zbatimin e strategjisë 2018-2022, për vitin 2018.

5. Informacionin në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që Ju drejtoni, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e të metave.

6. Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.

8. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive si dhe kontrollet e vendosura dhe funksionimi i tyre për çdo përgjegjës sektori dhe specialist, referenca e akteve ku mbështeten.

9. Informacion mbi ngarkesën e strukturës që Ju drejtoni në drejtim të aktiviteteve, burimeve njerëzore, aseteve dhe buxhetit pas reformës territoriale administrative."

Përgjigjet u vlerësuan dhe konsideruan në konkluzionet e auditimit.

Gjithshtu u përpiluan dhe u plotësuan në bashkëpunim me burimet njerëzore të DKSHM pyetësor dhe u plotësuan nga 10 drejtues të nivelit të lartë dhe të mesëm, me arsim të lartë, të moshës mesatare 37 vjec dhe nga përgjigjet rezultoi se:

Pyetjes "Në vlerësimin tuaj si është impakti i zbatimit të reformës territorial administrative?" iu përgjigjën për imiakt pozitiv 100% e të intervistuarve.

Pyetjes “Si paraqitet ngarkesa në punë gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2016?” u përgjigjën për ngarkesë më të lartë në punë 100% e të intervistuarve.

Pyetjes “Sa të motivuar jeni në punën tuaj të përditshme?” iu përgjigjën që ishin shumë të motivuar 100% e të intervistuarve.

Pyetjes “Si paraqiten të ardhurat tuaja nga paga, shpërblimet dhe benefice të tjera nga natyra në vitin 2018 në raport me vitin 2016?” iu përgjigjën 80% për të ardhura më të larta dhe 20% raportojnë se të ardhurat e tyre janë në të njëjtin nivel.

Pyetjes “Në pozicionin e drejtuesit a jeni të përfshirë në vendimmarrjen e DKSHM?” raportojnë se janë përfshirë në vendimmarrje 100% e të intervistuarve.

Pyetjes “A jeni njohur zyrtarisht me përgjegjësitë dhe kompetencat e pozicionit që mbani?” janë përgjigjur pozitivisht 100% e të inervistuarve.

Pyetjes “A keni qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018?” janë përgjigjur pozitivisht 80% e të inervistuarve dhe 20% nuk kanë kryer trajnime.

Pyetjes “A jeni njohur me strategjinë e DKSHM për periudhën 2018-2022?” janë përgjigjur pozitivisht 100% e të inervistuarve.

Pyetjes “Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia e Tirana Parking për vitin 2018 e në vazhdim?” 80% raportojnë tek buxheti vjetor, 20% tek plani strategjik.

Pyetjes “Për realizimin e objektivave të njësisë që drejtoni sa mendoni se ushtroni kompetencat tuaja?” 100% raportojnë plotësisht.

Pyetjes “A jeni përfshirë në procesin e rekrutimit përsa i përket plotësimit të stafit në njësinë që drejtoni?” 100% përgjigjen pozitivisht.

Pyetjes “Në cilën pjesë të analizës SËOT gjatë vitit 2018 keni kontribuar?” nuk ëshẗët përgjigjur asnjë.

Gjithshtu u përpiluan dhe u plotësuan në bashkëpunim me burimet njerëzore të DKSHM pyetësor dhe u plotësuan nga 21 specialist, me arsim të lartë, të moshës mesatare 41 vjec dhe nga përgjigjet rezultoi se:

Pyetjes “Në vlerësimin tuaj si është impakti i reformës territorial administrative?” iu përgjigjën 100% për impakt pozitiv.

Pyetjes “Si paraqitet ngarkesa në punë gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2016?” u përgjigjën për ngarkesë më të lartë 33% e të inervistuarve, 62% pa ndryshime dhe 5% e papërballueshme.

Pyetjes “Sa të motivuar jeni në punën tuaj të përditshme?” raportojnë për shumë të motivuar 100%.

Pyetjes “Si paraqiten të ardhurat tuaja nga paga, shpërblimet dhe benefice të tjera nga natyra në vitin 2018 në raport me vitin 2016?” 76% i kanë më të larta dhe 24% në të njëjtin nivel.

Pyetjes “Si është raporti i marrëdhëneve të eprorit tuaj me JU?” raportojnë 100% për marrëdhënie korrekte.

Pyetjes “A jeni njohur zyrtarisht me detyrat e vendit të punës dhe të drejtat tuaja?” 100% raportojnë se janë njohur me detyrat dhe të drejtat në punë.

Pyetjes “A keni qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018?” raportojnë pozitivisht 33% e të intervistuarve, 57% përgjgijen negativisht, 5% jashtë programit të institucionit dhe 5% nuk kanë kryer asnjë trajnim.

Pyetjes “A jeni njohur me strategjinë e DKSHM për vitin 2018?” raportojnë pozitivisht 95% e të intervistuarve, 5% vetëm cfarë kanë dëgjuar.

Pyetjes “Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018?” 19% tek plani strategjik dhe 81% tek përshkimi i punës për cdo vend pune .

Pyetjes “Ku mbështeten marrëdhëniet tuaja të punës në DKSHM?” 95% tek kodi i punës dhe 5% tek kontrata individuale e punës.

Pyetjes “A keni dijeni dhe a keni nënshkruar formularin për vlerësimin periodik të punës tuaj?” 95% përgjigjen pozitivisht dhe 5% negativisht.

1.Titulli Gjetjes	Funksionimi i kontrolleve të vendosura reflekton mangësi nga testimi i përgjigjeve me shkrim të strukturave drejtuese me përgjigjet e pyetësorëve në disa rubrika.
Situata:	Funksionimi i kontrolleve të vendosura reflekton mangësi nga testimi i përgjigjeve me shkrim të strukturave drejtuese me përgjigjet e pyetësorëve në disa rubrika. Raportohet se strukturat drejtuese janë përfshirë në vendimmarrje në masën 100% të të intervistuarve; kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme rreth 80% e të intervistuarve; janë njohur me strategjitë e njësisë për periudhën 2018-2022 rreth 100% e të intervistuarve nga të cilët 80% raportojnë se strategjia është reflektuar tek buxheti vjetor, 20% tek plani strategjik; në procesin e rekrutimit janë përfshirë 100% e drejtuesve dhe, pyetjes “Në cilën pjesë të analizës SWOT gjatë vitit 2018 keni kontribuar?” asnjë nuk ka qenë pjesë e analizës. Raportohet gjithashtu nga niveli i mesëm specialist se kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018 vetëm 33% e të intervistuarve dhe, pyetjes “A jeni njohur me strategjinë për vitin 2018?” raportojnë pozitivisht 95% e të intervistuarve. Gjithashtu pyetjes “Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018?” raportojnë 81% tek përshkimi i punës për cdo vend pune dhe 19% tek plani strategjik.
Kriteri	Kërkesat që burojnë nga ligji dhe aktet në zbatim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.
Ndikimi/Efekti	Në monitorimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së strukturave për njohjen, planifikimin dhe kontributin përvec realizimit të funksioneve të ngarkuara në arritjen e objektivave të njësisë.
Shkaku	Shmangie nga monitorimi rigoros dhe kontrolli sipas varësisë të strukturave drejtuese në dinamikën e përditshme të punës së stafit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi	Drejtori i DKSHM të marrë masa me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave

drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.

Auditim mbi organizimin, mbajtjen e kontabilitetit, hartimin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

*Për: **"Saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare", në Drejtorinë e Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit në varësi të Bashkisë Tiranë, në bazë të programit të auditimit nr. 1268/2, datë 18.12.2018, protokolluar në subjekt me nr. 161, datë 18/01/2019 mbajtur në datë 16/04/2019.***

Për auditimin e pikës 3.2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Pasqyrat financiare të vitit 2018 të shoqëruar me formatet 1-8.
2.Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2018, libri i aktiveve.
4. Miratimet e buxhetit vjetor për vitin 2018 dhe PBA (2018-2020), shkresat e ndryshimeve, raporti i monitorimit.
5. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2018.
6. Akrakordimet me Degën e Thesarit Tiranë në mbyllje të vitit buxhetor 2018.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:*** Për vitin 2018 nga njësia shpenzuese DKSHM hartimi i pasqyrave financiare dhe përgatitja e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhezimi nr 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe rapotimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontollin".

Lidhur me operacionet buxhetore, është i rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë përcjellëse nr. 168 prot., datë 20.02.2019.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2018 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve në kartelat e llogarive të librit të madh.
Nga verifikimi i akt rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabel ne llogarine e 520 "Disponibilitete në Thesar"dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Klas.Buxh	Pershkrimi	Shuma	Shuma Viti 2018	Rritje te autorizuar	Derdhu.Bashki	Mbeten per trasheguar
4665100	Trasheguar viti 2017	8,871,962.00		7,016,067.00		1,855,895.00

4665100	Te ardhura pezull 2018		6,941,258.00			6,941,258.00
	Transferim paradhenie					
4665100	**Shuma I**	**8,871,962.00**	**6,941,258.00**	**7,016,067.00**		**8,797,153.00**
7111099	Te ardhura per Bashkine		6,744,125.00		6,744,125.00	
	Shuma II		**6,744,125.00**			
	Shuma Totale	**8,871,962.00**	**13,685,383.00**	**7,016,067.00**	**6,744,125.00**	**8,797,153.00**

Këto veprime janë përfshirë edhe me formatin nr. 3 "Pasqyra e flukseve monetare (cash`floë)" të paraqitur më poshtë:

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE(CASH'FLOË)

(Sipas Metodes direkte) **Viti 2018**

NE / LEKE

Nr. Reshti	**Nr Rubrike**	**PERMBAJTJA**	**Periudha Raportuse**	**Periudha Paraardhese**
(a)	**(b)**	**(c)**	**(1)**	**(2)**
1	**I**	**VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT**	**24,542,279**	**39,230,383**
2	**1**	**Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)**	139,603,405	132,908,765
3	**2**	**Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor**	**13,685,383**	**13,196,802**
4		Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	0	
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	0	
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	6,744,125	5,747,030
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	6,941,258	7,449,772
10		Te tjera, arketuar(+)		
11	**3**	**Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente**	**-128,746,509**	**-106,875,184**
12		Per detryrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)	-9,453,520	
13		Per detryrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-112,276,922	-99,444,097
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	-7,016,067	-7,431,087
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-)		
18	**II**	**VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE**	**0**	**0**
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	2,608,560	2,100,000
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detryrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
24		Per detryrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-2,608,560	-2,100,000
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividente te paguar(-)		
28	**III**	**TRANSFERTA E TE TJERA**	**-24,617,088**	**-39,211,698**
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		-3,069,196
30		Transferime ne buxhet te Fondevete pa perdorura(-)	-17,872,963	-30,395,472
31		Levizje e brendshme e transferta te tjera(+-)	-6,744,125	-5,747,030
32	**IV**	**Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare**	**-74,809**	**18,685**
33	**V**	**Teprica ne fillim te vitit ushtrimor**	**8,871,962**	**8,853,277**
34	**VI**	**Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor**	**8,797,153**	**8,871,962**

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikes si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në rregjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabiltetit.***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj si dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Përsa i përket sistemimeve janë evidentuar në kartelat kontabël të llogarive përkatëse dhe artikujve kontabël të prerë për veprime të ndryshme janë evidentuar në librin e veprimeve të ndryshme. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi pershkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhena per shkakun e veprimit, daten dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vleres, personat qe kane urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhenat te nevojshme qe i japin dokumentit forcen e nje prove ligjore ose administrative. Kështu : Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si Memot–kërkesë për financim për veprimet ekonomike të kryera mga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit,akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Konkluzion: Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe celjen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyn pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.
Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël"Kapitulli I,pika 1.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financaiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018.
Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhen nën auditim
Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të rregjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin rregjistruar janë rregjistruar
Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e rregjistruara dhe ngjarjet janë rregjistruar në mënyrë të përshtatshme
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në periudhen e saktë kontabël
Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion
Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhes
Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë
Të drejtata dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe fondet e veta që duhet të ishin rregjistruar janë rregjistruar
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të rregjistruara.
Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese
Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.
Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2018 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2017.
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2018 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;
Totali i Aktivit për vitin 2018 është 158,178,194 lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

NE / LEKE

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	**A**	**A K T I V E T**	**158,178,194**	**173,236,934**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**38,169,974**	**45,742,994**
3		**1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre**	**8,797,153**	**8,871,962**
4	531	Mjrete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjrete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	8,797,153	8,871,962
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**17,160,044**	**18,738,629**
12	31	Materiale	8,442,796	9,178,677
13	32	Inventar I imet	8,717,248	9,559,952
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		**3.Llogari te Arketushme**	**12,212,777**	**18,132,403**
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	2,348,987	2,348,987
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	6,088,062	6,329,896
	468	Detyrime te prapambetura sherbime (furnitore)	3,775,728	8,738,056
	468	Detyrime te prapambetura te tjera		715,464
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**0**
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**120,008,220**	**127,493,940**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime		
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**120,008,220**	**127,493,940**
48	210	Toka, T,roje, Terene		

49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	107,584,273	113,246,603
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje		
53	215	Mjete Transporti	584,784	730,980
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	11,839,163	13,516,357
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		**4.Investime**	**0**	**0**
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		

II. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata:

1. ***Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata***, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave te UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj afatgjata sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten në shumën totale prej 120,008,220 lekë. Për këto aktive janë kryer inventare fizike nga komisionet e inventarizimit, kjo sipas fletëve të inventarizimit të paraqitura dhe të

konfirmuara nga këto komisione. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:
- ***Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione"*** në datë 31.12.2018 është në vlerën kontable 107,584,273 lekë, zvogëluar për shkak të amortizimit.
- ***Gjendja e llogarisë 215*** "Mjete Transporti" në datën 31.12.2018 është në vlerën kontable 584,784 lekë, zvogëluar nga viti paraardhës për vlerën e amortizimit.
- ***Gjendja e llogarisë 218*** "Inventar Ekonomik" në datën 31.12.2018 është në vlerën kontable 11,839,163 lekë.

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata material dhe jomateriale është paraqituir drejt për vitin 2018, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për cdo aktiv si dhe është kryer procesi i inventarizimit i cili rakordon me gjëndjen kontabël për cdo aktiv, gjë që "certifikon" vlerat e aktiveve, duke ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Për aktivet e krijuara pas viteve 2011 në kartelat kontabël për cdo aktiv ekzistojnë të gjitha të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Ndërsa për aktivet e krijuara para viteve 2011 si për shtesat dhe pakësimet të rezultuara nga veprimet ekonomike të kryera për aktivet ekzistuese para viteve 2011 mungojnë të dhënat kontabël, për vlerat fillestare të hyrjes dhe për shtesat apo pakësimet që kanë ndikuar në arritjen e vlerës së aktivit të paraqitur në vitin 2011 duke e kthyer këtë vit si vitin fillestar.

<u>Inventarizimi i aktiveve për vitin 2018</u>

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" DKSHM ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2018.

Me urdhërin nr. ……., datë …… është ngitur komisioni inventarizimit dhe vlerësimit për pajisjet e inventarit ekonomik dhe pajisjeve teknike, mjeteve të transportit, trojeve ndërtesave në pronësi të DKSHM.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve afatgjata material dhe jomateriale dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga këto komisione dhe përgjegjësit material brenda muajit janar 2019.

Gjithashtu është kryer inventarizimi në dy magazinat e institucionit. Nga komisioni i inventarizimit për të dy magazinat para fillimit të inventarit është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit. Nga komisioni është hartuar lista e artikujve gjendje në magazina, e cila rezulton të jetë e barabartë me gjendjen në kontabilitet. Nga auditimi i dokumentacionit për të dy magazinat rezultoi se janë kryer veprimet për inventarin fizik të gjithë artikujve dhe janë krahasuar me gjendjen kontabël dhe nuk kanë rezultuar diferenca. Fletët e inventarizimit janë firmosur nga komisioni i inventarizimit dhe përgjegjësit material, si dhe është hartuar relacioni i rezultatit të inventarit për secilën magazinë më datën 31.12.2018.

Në klasën 3 "Gjendja e inventarit" të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2018 në vlerën 17,160,044 lekë. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:
- ***Gjendja e llogarisë 31*** **"Materiale"** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 8,442,796 lekë.
- ***Gjendja e llogarisë 32*** **"**Inventari i imet**"** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 8,717,248 lekë.

- ***Gjendja e llogarisë 4342*** "Të tjera operacione me shtetin" me shumën 6,088,062 lekë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2018 të cilat trashëgohen në vitin 2019, e cila në analizë përfshin gjëndjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 "Detyrime ndaj personelit" për vlerën 4,372,621 lekë, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 249,260 lekë, llog.435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 869,815 lekë, llog.436"Sigurime shëndetësore" për vlerën 583,349 lekë dhe llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" për vlerën 13,017 lekë.

- ***Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"*** paraqitet në vlerën prej 3,775,728 lekë, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

65	**B**	**PASIVET(DETYRIMET)**	**18,660,943**	**24,655,378**
66		**I.Pasivet Afat shkurtra**	**18,660,943**	**24,655,378**
67		**1. Llogari te Pagushme**	**18,660,943**	**24,655,378**
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to		
69	42	Detyrime ndaj personelit	4,372,621	4,391,025
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	249,260	393,145
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	869,815	883,768
76	436	Sigurime Shendetsore	583,349	592,708
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	8,797,153	8,871,962
82	467	Kreditore te ndryshem	13,017	69,250
	467	Kreditore te ndryshem detyrim I prapambetur	3,775,728	9,453,520
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime		
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**0**	**0**
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
91		**II.Pasivet Afat Gjata**	**0**	**0**
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**139,517,251**	**148,581,556**
97	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**139,517,251**	**148,581,556**
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	137,938,666	148,581,556
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	1,578,585	
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne		

104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	**E**	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**158,178,194**	**173,236,934**

- ***Gjendja e llogarisë 101 "Fonde bazë"*** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 137,938,666 lekë, me zvogëlim për vlerën 9,064,305 lekë nga viti paraardhës ku përfshihen rezultati i veprimtarisë llog. 85 për vlerën 1,578,585 lekë, amortizimi i aktiveve afatgjata dhe daljet jashtë përdorimit si dhe grante të brendshme.

Të dhënat e lëvizjeve të fondeve në mënyrë më të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Reference	**E M E R T I M I**	**dhe Grante Kapitale**	**e Ushtrimit Teprioce/Deficit**	**Aktive/neto Fonde/ Neto**
b	**c**	**1**	**5**	**6**
101	**I.AKTIVET NETO/FONDET NETO**	**148,581,556**		**148,581,556**
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)		**-9,064,305**	**-9,064,305**
	1.NGA BURIME TE BRENDSHME		**-9,064,305**	**-9,064,305**
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)		2,608,560	**2,608,560**
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)			**0**
1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)			**0**
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)		-1,578,585	**-1,578,585**
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)			**0**
111	Nga Rezervat (+.-)			**0**
115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)			**0**
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)			**0**
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)		**-7,163,510**	**-7,163,510**
1015	Nga nxjerrjet jashteperdorimit dhe demtimet(-)		**-2,930,770**	**-2,930,770**
107	Vlera te AAGJ, te Caktuara ne perdorim(+.-)			**0**
109	Diferenca nga Rivleresimi I AAGJ(+,-)			**0**
	2.NGA BURIME TE JASHTME			**0**
106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)			**0**
1016, 1069	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)			**0**
	TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	**148,581,556**	**-9,064,305**	**139,517,251**

Për këtë vlerë janë kryer veprimet kontabël:
Për shtesat e aktiveve në debi të aktiveve sipas llojit dhe në kredi të llog.101 "Fonde bazë". Për shtesat e ndryshimit të gjendjeve të inventareve që janë me efekt pozitiv është debituar llog. 8423 "Transferim i ndryshimit të gjendjeve" në kredi të llog.101 "Fonde bazë". Ndërsa për amortizimin e aktiveve llog.1012 "Paksim i fonde bazë" është debituar në kredi të llog. 1013 "Konsumi i aktiveve te qendrueshme",

- ***Gjendja e llogarisë 42 "Personeli e llogari të lidhura me to"*** në vlerën kontabël 4,372,621 lekë, paraqet vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2018 për pagat që do të paguhen në janar të vitit pasaardhës.

- ***Gjendja e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat"*** në bilanc paraqitet në vlerën kontabël 249,260 lekë, e cila tatime mbi të ardhurat etj.

- ***Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore"*** paraqitet në bilanc në vlerën kontabël 869,815 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për sigurimet e paderdhura për muajin dhjetor 2018.
- ***Gjendja e llogarisë 436 "Sigurime shëndetësore"*** paraqitet në bilanc në vlerën kontabël 583,349 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për sigurimet shëndetësore të paderdhura për muajin dhjetor 2018.

- ***Gjendja e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"*** , sipas bilancit në fund të vitit 2018 paraqitet në shumën **8,797,153 lekë** , e cila përfshin paradhënie të marra nga nxënësit për një muaj me qëllim most ë krijohen debitor në fund të vitit shkollor si dhe sistemimi i nxënësve që nuk u është miratuar bursë.
- ***Gjendja e llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm"*** më datë 31.12.2018 është në **vlerën 13,017 dhe 3,775,728 lekë të cilat janë për tu kthyer nxënësve me mbarimin e vitit shkollor 2018-2019, të mbartura nga vitet 2015, 2016, e në vazhdim**.

1.Titulli Gjetjes	-Mos kontabilizim i kontratave për mallra e shërbime në momemntin e lidhjes së tyre.
Situata:	- Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe celjen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyn pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.
Kriteri	Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" Kapitulli I,pika 1.
Ndikimi/Efekti	- Me pasojë mospasqyrim në kontabilitet në vlerë të plotë të kontratave të lidhura për mallra dhe shërbime me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare.
Shkaku	- Mospasqyrimi i plotë i angazhimit, për arsye të rritjes në vlerë të lartë të detyrimeve në bilanc
Rëndësia:	-I mesëm.
Rekomandimi	Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentintin e nënshkrimit të tyre.

2.Titulli Gjetjes	-Mangësi në programimin dhe realizimin e buxhetit, mungesa e analizave faktoriale të tij si dhe mangësi në monitorimin e buxhetit.
Situata:	Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet 2016-2018, u konstatua se: a. Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të

kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

b. Nëpunësi autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, në Bashki raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, aktivitetet dhe objektivat e realizuara për çdo projekt, të përcaktuara në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm", nga ku konstatojmë se ka mangësi për sa i takon analizës së aktiviteteve në bazë produktesh për cdo program. Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme,të mefshtësisë dhe mosefektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë riskuar dhe nxitur shkurtimin e morealizimin shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përllogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimin e tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.

Kriteri Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253,354

Ndikimi/Efekti - Përformancë jo në shkallën e duhur e aktivitetit të administratës gjatë planifikimit buxhetor si për PBA dhe projektbuxhetin vjetor.

Shkaku - Diktimi nga Bashkia Tiranë sipas përcaktimeve në programet buxhetore pasi orientimet nuk lënë hapësirë për vlerësim të saktë të nevojave të institucionit.

- Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave.

Rëndësia: -I mesëm.

Rekomandimi a. Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për cdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim efiçent të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.

b. Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i "shkaktojnë" këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve

mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor.

Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017.

Në zbatim të pikës B, 1.5/1.6 të programit të auditimit "Nr. 1268/2, datë 18/12/2018", u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:-

-Regjitri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike

-Evidenca nga sistemi informatik i APP për menaxhimin e procedurave të prokurimit.

-Dosjet e procedurave të prokurimit për periudhën 2016-2018.

Nga auditimi rezultoi se në *Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme*, <u>për vitin 2016</u>, janë zhvilluar gjithsej 17 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 24,754,371 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 21,956,872 lekë, duke kursyer shumën prej 2,797,499 lekë ose në masën 11% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-"Blerje me vlerë të vogël", 8 procedura, me fondin limit në total prej 2,408,991 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,944,180 lekë, duke kursyer shumën prej 464,811 lekë;

-"Kërkesë për propozim", 5 procedura, me fondin limit në total prej 13,714,499 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 12,928,782 lekë, duke kursyer shumën prej 785,717 lekë.

-"Tender i Hapur", 4 procedura, me fondin limit në total prej 8,630,881 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 7,083,910 lekë, duke kursyer shumën prej 1,546,971 lekë.

Gjithashtu janë zhvilluar 8 procedura prokurimi jashtë sistemit elektronik të APP të llojit "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", me fondin limit në total prej 4,815,647 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 4,803,480 lekë, duke kursyer shumën prej 12,167 lekë.

<u>Për vitin 2017</u>, janë zhvilluar gjithsej 14 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 23,272,097 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 20,706,045 lekë, duke kursyer shumën prej 2,566,052 lekë ose në masën 11% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-"Blerje me vlerë të vogël", 6 procedura, me fondin limit në total prej 1,957,703 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,632,479 lekë, duke kursyer shumën prej 325,224 lekë;

-"Kërkesë për propozim", 5 procedura, me fondin limit në total prej 16,025,785 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 14,855,566 lekë, duke kursyer shumën prej 1,170,219 lekë.

-"Tender i Hapur", 3 procedura, me fondin limit në total prej 5,288,609 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 4,218,000 lekë, duke kursyer shumën prej

1,070,609 lekë.

Gjithashtu janë zhvilluar 5 procedura prokurimi jashtë sistemit elektronik të APP të llojit "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", me fondin limit në total prej 4,668,902 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 4,525,250 lekë, duke kursyer shumën prej 97 lekë.

Për vitin 2018, janë zhvilluar gjithsej 15 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 23,692,364 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 20,645,158 lekë, duke kursyer shumën prej 3,047,206 lekë ose në masën 13% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-"Blerje me vlerë të vogël", 6 procedura, me fondin limit në total prej 1,465,517 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,215,920 lekë, duke kursyer shumën prej 249,597 lekë;

-"Kërkesë për propozim", 5 procedura, me fondin limit në total prej 14,050,229 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 12,913,613 lekë, duke kursyer shumën prej 1,136,616 lekë.

-"Tender i Hapur", 3 procedura, me fondin limit në total prej 7,068,175 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 5,421,165 lekë, duke kursyer shumën prej 1,647,010 lekë.

-"Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit", 1 procedurë, me fondin limit në total prej 1,108,443 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,094,460 lekë, duke kursyer shumën prej 13,983 lekë.

Gjithashtu janë zhvilluar 8 procedura prokurimi jashtë sistemit elektronik të APP të llojit "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", me fondin limit në total prej 6,244,175 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 6,209,481 lekë, duke kursyer shumën prej 34,694 lekë.

Në zbatim të pikës B, 1.3 të programit të auditimit "Nr. 1268/2, datë 18/12/2018", u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:-
-Evidenca nga sistemi informatik i APP-së për menaxhimin e procedurave të prokurimit.

-Dosjet e procedurave të prokurimit për vitin 2016-2018.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit të realizuara gjatë vitit 2018 me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi rezultoi për disa procedura të përzgjedhura si më poshtë vijon:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt, Kërkesë për Propozim "Blerje ushqime blegtorale për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme"
1. Urdhër Prokurimi Nr. 313 Prot,Datë 28.04.2017

2. Lloji I Procedurës së Prokurimit " Kërkesë për propozim "	**3.Hartuesi I Dokumentave të Tenderit .** Nr. 313 Prot,Datë 28.04.2017 me përbërjë si më poshtë: E. B. Anëtar R. M. Anëtar G. S. Jurist	**4. Komisioni I Vlerësimit të Ofertave** Nr. 314 Prot Datë 28.04.2017 me përberjë si më poshtë : L. R. Kryetar Sh. M. Anëtar H. G. Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 4.325.833 lekë	6.Oferta Fituese (Pa TVSH) 3.546.200 lekë	7. Diferenca me Fondin Limit (Pa TVSH) 779.633 lekë
8. Data e Hapjes së Tenderit. Datë 18.05.017	**9. Burimi I financimit .** 1. Buxheti I bashkise Tiranë 2. Ministria e mireqenies	**10. Operatorët Ekonomik** a) Pjesmarrës në Tender, 6 OE b) Skualifikuar , 4 OE c) Kualifikuar, 2 OE
11. Ankimime AK- Nr.178 Prot,datë12.05.2017, Nr. 179 Prot,datë 12.05.2017 APP- s'ka, KPP- s'ka	**12.Përgjigje Ankesës nga AK.** Nr.347 Prot,datë 15.05.2017 Nr.348 Prot,datë 15.05.2017	**13. Përgjigje Ankesës Nga APP apo KPP.** S'ka
b. Zbatimi I Kontratës Punimeve / Sherbimeve / Mallrave		
14.Lidhja e Kontratës Nr. 416 Prot, Datë 29.06.2017	15. Vlera e Kontratës (me TVSH) 4.255.440 lekë	**16. Likujduar plotësisht sipas Kontratës**. Afati i realizimit të kontatës:nga data e lidhjes së kontratës deri në 31.12.2017.
17. Situacioni Përfundimtar	**18. Afati Kontratës në ditë.** Afati i realizimit të kontatës:nga data e lidhjes së kontratës deri në 31.12.2017.	**19. Zgjsatja e Kontratës Në Ditë.** S'ka zgjatje .
20. Mbikqyresi I punimeve. Ska	License Nr, Kontratë Nr	Likujduar lek , Pa likujduar
21.Kolaudatori I punimeve S'ka	License Nr, Kontratë Nr	Likujduar lek , Pa likujduar
22. Akt Kolaudimi	**23. Akt Marrja në dorëzim** Nr.313/1 datë 28.04.2017	

1-Në dokumantacionin e administruar në dosjen e sistemit të prokurimit elektronik në APP (Ref.11-392) për procedurën me objekt;" Blerje ushqime bleqtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme" u konstatuan mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi konkretishtë;

-Nëpërmjet njoftimit të fituesit datë 09.06.2017 konstatohet se, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE "*K.*" shpk me vlerë *3.546.200 lekë pa tvsh*, ndërsa nuk ka kualifikuar ofertën e paraqitur nga OE "*L.*"shpk me vlerë *3.165.600 lekë pa tvsh*, vlerë kjo më e ulët se vlera e ofertës e shpallur fituese me diferencë shuma ***380,600 lekë pa tvsh*** me argumentin se: kjo ofertë nuk ka plotësuar*"Kritere të vecanta për kualifikim"*, pika 1.3 *"Kapaciteti Teknik",* ku me analizë evidentohet **sa më poshtë;**

a-pikën 1.3;-"OE per te gjitha mjetet e deklaruara ne dokumentat e tenderit ne funksion të realizimit të kontratës nuk ka paraqitur çertifikatën e pronësisë së këtyre mjeteve, duke mos përmbushur kriteret e vecanta per kualifikim pika 1.3, Kapaciteti teknik ku specifikisht kërkohet nga autoriteti kontraktor: Ofertuesi duhet te ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjete transporti te vlefshme per gjithe periudhen e zbatimit te kontratës për furnizimin e ushqimeve blegtorale, si me poshte: Automjet te pershtatshem (frigoriferik ATV)per artikujt e bulmet e mish (2 cope). Per automjetet te paraqitet certifika pronesise, kontrata e dhurimit apo qirase sipas rastit dhe dokumentacioni perkates, Certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe Siguracion te automjeteve ne dispozicion si dhe leje per transport mallrash. (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshmëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi).

-"*Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2, gërma "ç", përcaktohet se:"Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:[...] e.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri". Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me* ***Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011*** *"Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", përcaktohet shprehimisht që:* ***"Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar."***

Nisur nga sa me siper Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "L." sh.p.k. nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kërkesa për pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike nuk plotësohet. Konkretisht, rezulton se operatori ekonomik "L." nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se shoqëria "L." sh.p.k rezulton *të ketë të papaguar faturën e muajit Mars 2017. Lidhur me këtë fakt, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjykon se operatori ekonomik "L." shpk nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi procedura e prokurimit është publikuar në datën 08.05.2017, dhe hapja e ofertave është zhvilluar në datën 05.06.2017, kohë në të cilën operatori ekonomik në fjalë kishte mundësinë e likujdimit të faturës së energjisë elektrike për muajin Mars 2017 në mënyrë që të përmbushte kriteret për kualifikim. Operatori ekonomik "L." shpk, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, nuk ka vërtetuar se ka shlyer të gjitha detyrimet e matuara të energjisë elektrike, përfshirë edhe detyrimet për muajin Mars 2017, data maksimale përfundimtare për shlyerjen e të cilit, mbështetur në nenin e sipërcituar, ishte data 30.04.2017. Në Vendimi ERE nr.109, datë 21.10.2011 përcaktohet se:* ***"****Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore.....* ***jo më vonë se*** *ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar."cka do të thotë se afati 30.04.2017 është dita e fundit për shlyerjen e këtij detyrimi. Ofertuesit e mundshëm dhe në rastin konkret shoqëria "L." e cila shpreh interesin për të marrë pjesë në këtë procedurë kishte kohë të mjaftueshme për likujdimin e detyrimit për muajin Mars 2017. pasi detyrimi nuk mund të shlyhet pas datës 30.04.2017*".

-"*Per kompleks stallor paraqitur OE "L."shpk ka paraqitur dokumentacionin sa me poshte vijon: Është paraqitur kontrata me shoqerine "Fogi"shpk e cila nuk eshte me kontrate noteriale sic është kërkuar në kriteret e vecanta per kualifikim kapaciteti teknik. Gjithashtu ne lidhje me kete kontrate nuk eshte paraqitur leje mjedisore e tipit C kategoria III.1.A "Per therrtore" sic eshte kerkuar ne kriteret e vecanta per kualifikim por leje mjedisore me kategorine III.1.B "Per mbareshtim te kafsheve te gjalla" duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim Kapaciteti Teknik. Gjithashtu Akti miratimit nuk eshte per leje mjedisore te tipit C me objekt "Therrtore" por per leje mjedisore me objekt "Per mbareshtim lopesh per prodhim qumeshti" duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim. Per therrtoren nuk eshte paraqitur planimetria dhe gjurma ne harten rajonale duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik. Ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik "L." shpk ka paraqitur nje kontrate me shoqerine "K." ku i gjithe dokumentacioni bashkengjitur kontrates eshte teresisht i paqarte dhe i palexueshem, duke u bere i pamundur*

identifikimi i te dhenave te tij dhe verifikimi i tyre nese jane ne perputhje me kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit me qellim krijimin e nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesive te operatorit ekonomik per permbushjen me sukses te kontrates.,

Sa më sipër, sqarojmë se është detyrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik për paraqitjen dhe hedhjen e dokumentacionit të plotë, të saktë e të qartë për nga mënyra e leximit dhe identifikimit të të dhënave të tij, në mënyrë që të jetë i lexueshëm dhe për të verifikuar nëse ai është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "L."shpk per kontraten e paraqitur me shoqerine "K" nuk mund te konsiderohet i vlefshem". Sa më sipër në të dy kontratat e paraqitura në plotësim të këtij kriteri për thertore nuk plotësojne kriteret e percaktuara nga AK në DST.

Nga auditimi dokumentacionit i administruar në dosjen e procedurës e pasqyruar në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se; oferta me vlerë më të ulët e konsideruar e pavlerësuar drejtësisht e vlerësojmë se kërkesat kualifikuese të dorëzuara nga ky OE janë të plotësuara dhe KVO-ja gjatë shqyrtimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit *"oferta më e ulët"* në procesin e vlerësimit duhej të kishte qënë më fleksibël për të kualifikuar edhe ofertën e dorëzuar nga OE "*L.*" shpk me vlerë *3.165.600 lekë pa tvsh,* si ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme dhe dokumentat e paraqitura në konkurim nuk kanë sjell asnjë deformim të ofertës, në përmbushje të detyrimeve të parashikuar nga neni 53 pika 1, ku <u>citohet qartësishtë</u>; *"Autoriteti kontraktor kur e shikon të arsyeshme u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 e 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme"*dhe neni 54 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, pasi mangësitë e pa analizuara në vlerësimin e ofertës, pa cilësuar dhe pa cënuar thelbin e ofertës të parashikuara në LPP, ndërsa KVO-ja duhej të ishte kërkuar arsyetim me informacion shtesë nga ky OE konkurues me ofertë ekonomike më favorizuese sepse;
<u>-për pikën 2, gërma (ç)</u>; *"..konstatohet se për shlyerjen e detyrimit të energjisë është kërkuar vetëm;* ***(Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri).....****", ndërsa KVO ka kërkuar jashtë kësaj kërkese përfshirjen e muajit mars 2017, por ky komision mban 2 qëndrime të ndryshme për të njëjtën kërkesë kualifikuese, sepse oferta e paraqitur nga OE konkurues "G."shpk me vertëtimin e energjisë nr.307, datë 12.04.2017 është kualifikuar, ndërkohë që ka të njëtjën përmbajtje dhe datë"...,* për pasojë oferta me këtë dokunement i dorëzuar në konkurim plotëson kërkesën kualifikuese.

<u>-për pikën 1.3</u>;*"..konstatohet se, dokumentacioni për kompleksi stallor është paraqitur kontrata me shoqerine "Fogi"shpk e cila është kontratë me vulë të njomë të zyrës noteriale...."*, për pasojë oferta me këtë dokunement i dorëzuar në konkurim plotëson kërkesën kualifikuese.

<u>-për pikën 1.3</u>; *".....është e vërtet që dokumetacioni i objektit thertore është në kushtet e pa dukshme dhe për objektin tjetër thertore është e paisur me leje III.1.B, por është i paisur më leje nga Inspektoriati shtetror shëndëtsor, njëkohësisht referuar në Shtojca 19 Sasia dhe grafiku i lëvrimit ku sasia e mishit për tu furnizuar është vetëm 900 kg, kërkesa për kualifikuese që OE të ketë në pronësi apo me qera një objekt thertore me sipërfaqe jo më të vogël se 150 m2 është kërkesë e pa argumentuar.....",* për pasojë kjo kërkesë duhet të konsiderohet devijim i vogël duje kërkuar edhe informacion shtesë për vlerësimin e kërkesës kualifikuese.

Në këto kushte vlerësimi bërë nga KVO për shpalljen e ofertës fituese, është në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", neni 20 "*Mosdiskriminimi*", neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", neni 52 "*Hapja e ofertave*" pika (1); (6), neni 53 "*Shqyrtimi i ofetave*", pika (1);

neni 54 "*Alternativat*", neni 55 "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Kreu (VII) "*Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave*"; neni 64 "*Hapja e ofertave*"; neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*"; neni 67 "*Klasifikimi i ofertave*"; neni 68 "*Raporti përmbledhës*"; neni 74 "*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*", pasi ka skualifikuar ofertën me vlerë më të ulët e cila plotëson kriteret për kualifikim, për pasojë vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertës fituese me vlerë ***3.546.200 lekë pa tvsh*** me diferencë më tepër shuma ***380,600 lekë pa tvsh*** *(3546200-3165600)* ***përbën efekt negativ finaciar për buxhetin Bashkia Tiranë duke mos siguruar efektivitetin e fondeve në shumën 380,600 lekë pa tvsh.***

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt, Kërkesë për Propozim : "Blerje ushqime blegtorale për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme".		
1. Urdhëri Prokurimi Nr. 198 Prot,Datë 16.03.2018		
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit " Kërkesë për propozim	**3.Hartuesi I Dokumentave të Tenderit .** Nr. 198 Prot,Datë 16.03.2018 me përbërjë si më poshtë: E. B. Anëtar R. M. Anëtar G. S. Jurist.	**4. Komisioni I Vlerësimit të Ofertave** Nr. 199 Prot,Datë 16.03.2018 me përberjë si më poshtë : L. R. Kryetar H. G. Anëtar S. B. Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 5.547.756 lekë	**6.Oferta Fituese (Pa TVSH)** 4.668.050 leke	**7. Diferenca me Fondin Limit (Pa TVSH)** 879.706 lekë
8. Data e Hapjes së Tenderit. Datë 30.03.2018	**9. Burimi I financimit .** 1. Buxheti i Bashkisë Tiranë 2. Ministria e Financave	**10. Operatorët Ekonomik** a) Pjesmarrës në Tender , 5 OE b) Skualifikuar , 3 OE c) Kualifikuar , 2 OE
11. Ankimime AK Nr. 180 Prot, datë 10.04.2018, Nr. 181 Prot, datë 10.04.2018 APP-S'ka KPP Nr. 189 Prot, datë 16.04.2018	**12.Përgjigje Ankesës nga AK.** Nr275 Prot,datë 12.04.2018. Nr.274 Prot,datë 12.04.2018	**13. Përgjigje Ankesës Nga APP apo KPP.** Nr.327 Prot, date 27.06.2018
b. Zbatimi I Kontratës Punimeve / Sherbimeve / Mallrave		
14.Lidhja e Kontratës Nr. 431 Prot, Datë 06.07.2018	**15. Vlera e Kontratës (me TVSH)** 5.601.660 lekë	**16. Likujduar plotësisht sipas Kontratës.** Afati i realizimit të kontatës:nga data e lidhjes së kontratës deri në 31.12.2018.
17. Situacioni Përfundimtar	**18. Afati Kontratës në ditë.** Afati i realizimit të kontatës:nga data e lidhjes së kontratës deri në 31.12.2018.	**19. Zgjsatja e Kontratës Në Ditë.** S'ka zgjatje .
20. Mbikqyresi I punimeve. Ska	License Nr, Kontratë Nr	Likujduar lek , Pa likujduar
21.Kolaudatori I punimeve S'ka	License Nr, Kontratë Nr	Likujduar lek , Pa likujduar
22. Akt Kolaudimi	**23. Akt Marrja në dorëzim** Nr.203 datë 16.03.2018	

2-Në dokumantacionin e administruar në dosjen e sistemit të prokurimit elektronik në APP (Ref.57-002) për procedurën me objekt;" Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme" u konstatuan mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi konkretishtë;

-Nëpërmjet njoftimit të fituesit datë 04.04.2018 konstatohet se, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE "K."shpk me vlerë *4,668,050 lekë* pa tvsh, ndërsa nuk ka kualifikuar ofertën e paraqitur nga OE "*L.*"shpk me vlerë *3,986,300 leke pa tvsh*, njëkohësishtë edhe ofertën e paraqitur nga OE "*Dogel*"shpk me vlerë *4,003,900 lekë pa tvsh* edhe kjo vlera më e ulët se oferta e shpallur D. me diferencë shuma ***664,150 lekë pa tvsh.***

Nga auditimi dokumentacionit i administruar në dosjen e procedurës e pasqyruar në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se për këtë ofertë me vlerë më të ulët, KVO nuk e ka konsideruar në njoftimin dhe shpalljen e fituesit dhe nuk e ka shqyrtuar dhe vlerësuar me kërkesat kualifikuese të dorëzuara, ndërsa nga verifikimi i dokumentave të OE "D."shpk janë të plotësuara dhe KVO-ja gjatë shqyrtimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LPP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit "oferta më e ulët" në procesin e vlerësimit duhej të kishte qënë më fleksibël për të kualifikuar edhe ofertën e dorëzuar nga OE "D."shpk me vlerë 4,003,900 lekë pa tvsh, si ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme dhe dokumentat e paraqitura në konkurim nuk kanë sjell asnjë deformim të ofertës, në përmbushje të detyrimeve të parashikuar nga neni 53 pika 1, ku citohet qartësishtë; "Autoriteti kontraktor kur e shikon të arsyeshme u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 e 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme"dhe neni 54 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pasi mangësitë e pa analizuara në vlerësimin e ofertës, pa cilësuar dhe pa cënuar thelbin e ofertës të parashikuara në LPP, ndërsa KVO-ja duhej të ishte kërkuar arsyetim me informacion shtesë nga ky OE konkurues me ofertë ekonomike më favorizuese.

Në këto kushte vlerësimi bërë nga KVO për shpalljen e ofertës fituese, është në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", neni 20 "*Mosdiskriminimi*", neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", neni 52 "*Hapja e ofertave*" pika (1); (6), neni 53 "*Shqyrtimi i ofetave*", pika (1); neni 54 "*Alternativat*", neni 55 "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Kreu (VII) "*Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave*"; neni 64 "*Hapja e ofertave*"; neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*"; neni 67 "*Klasifikimi i ofertave*"; neni 68 "*Raporti përmbledhës*"; neni 74 "*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*", pasi ka skualifikuar ofertën me vlerë më të ulët e cila plotëson kriteret për kualifikim, për pasojë vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertës fituese me vlerë ***4,668,050 lekë pa tvsh*** me diferencë më tepër shuma ***664,150 lekë pa tvsh****(4668050-4003900)* ***përbën efekt negativ finaciar për buxhetin e Bashkisë Tiranë duke mos siguruar efektivitetin e fondeve në shumën 664,150 lekë pa tvsh.***

Për sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet për problematikat e trajtuara dhe qëndrimin strikt ndaj plotësimit të kritereve duke mos u udhëhequr nga qëllimi kryesor i prokurimit publik ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike, janë objekt i veprimtarisë së Njësisë së Prokurimit dhe KVO sipas rastit trajtuar në procedurat e mësipërme.

1. Titulli i Gjetjes:	Kualifikimi i OE nga KVO, veprime të cilat kanë sjellë mos sigurimin me efektivitet të përdorimit të fondeve publike.
Situata:	1-Në dokumantacionin e administruar në dosjen e sistemit të prokurimit elektronik në APP (Ref.11-392) për procedurën me objekt;" Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme" u konstatuan mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi konkretishtë; -Nëpërmjet njoftimit të fituesit datë 09.06.2017 konstatohet se, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fituese

ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE "K." shpk me vlerë 3.546.200 lekë pa tvsh, ndërsa nuk ka kualifikuar ofertën e paraqitur nga OE "L."shpk me vlerë 3.165.600 lekë pa tvsh, vlerë kjo më e ulët se vlera e ofertës e shpallur fituese me diferencë shuma 380,600 lekë pa tvsh me argumentin se: kjo ofertë nuk ka plotësuar"Kritere të vecanta për kualifikim", pika 1.3 "Kapaciteti Teknik", ku me analizë evidentohet **sa më poshtë;**

a-pikën 1.3;-"OE per te gjitha mjetet e deklaruara ne dokumentat e tenderit ne funksion të realizimit të kontratës nuk ka paraqitur çertifikatën e pronësisë së këtyre mjeteve, duke mos përmbushur kriteret e vecanta per kualifikim pika 1.3, Kapaciteti teknik ku specifikisht kërkohet nga autoriteti kontraktor: Ofertuesi duhet te ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjete transporti te vlefshme per gjithe periudhen e zbatimit te kontratës për furnizimin e ushqimeve blegtorale, si me poshte: Automjet te pershtatshem (frigoriferik ATV)per artikujt e bulmet e mish (2 cope). Per automjetet te paraqitet certifika pronesise, kontrata e dhurimit apo qirase sipas rastit dhe dokumentacioni perkates, Certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe Siguracion te automjeteve ne dispozicion si dhe leje per transport mallrash. (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshmëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi).

-"Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2, gërma "ç", përcaktohet se:"Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:[…] e.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri". Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", përcaktohet shprehimisht që: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar."

Nisur nga sa me siper Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "L." sh.p.k. nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kërkesa për pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike nuk plotësohet. Konkretisht, rezulton se operatori ekonomik "L." nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se shoqëria "L. sh.p.k rezulton të ketë të papaguar faturën e muajit Mars 2017. Lidhur me këtë fakt, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjykon se operatori ekonomik "L." shpk nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi procedura e prokurimit është publikuar në datën 08.05.2017, dhe hapja e ofertave është zhvilluar në datën 05.06.2017, kohë në të cilën operatori ekonomik në fjalë kishte mundësinë e likujdimit të faturës së energjisë elektrike për muajin Mars 2017 në mënyrë që të përmbushte kriteret për kualifikim. Operatori ekonomik "L." shpk, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, nuk ka vërtetuar se ka shlyer të gjitha detyrimet e matuara të energjisë elektrike, përfshirë edhe detyrimet për muajin Mars 2017, data maksimale përfundimtare për shlyerjen e të cilit, mbështetur në nenin e sipërcituar, ishte data 30.04.2017. Në Vendimi ERE nr.109, datë 21.10.2011 përcaktohet se: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore..... jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar."cka do të thotë se afati 30.04.2017 është dita e fundit për shlyerjen e këtij detyrimi. Ofertuesit e mundshëm dhe në rastin konkret shoqëria "L." e cila shpreh interesin për të marrë pjesë në këtë procedurë kishte kohë të mjaftueshme për likujdimin e detyrimit për muajin Mars 2017. pasi detyrimi nuk mund të shlyhet pas datës 30.04.2017".

-"Per kompleks stallor paraqitur OE "L."shpk ka paraqitur dokumentacionin sa me poshte vijon: Është paraqitur kontrata me shoqerine "F." shpk e cila nuk eshte me kontrate noteriale sic është kërkuar në kriteret e vecanta per kualifikim kapaciteti teknik. Gjithashtu ne lidhje me kete kontrate nuk eshte paraqitur leje mjedisore e tipit C kategoria III.1.A "Per therrtore" sic eshte kerkuar ne kriteret e vecanta per kualifikim por leje mjedisore me kategorine III.1.B "Per mbareshtim te kafsheve te gjalla" duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim Kapaciteti Teknik. Gjithashtu Akti miratimit nuk eshte per leje mjedisore te tipit C me objekt "Therrtore" por per leje mjedisore me objekt "Per mbareshtim lopesh per prodhim qumeshti" duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim. Per therrtoren nuk eshte paraqitur planimetria dhe gjurma ne harten rajonale duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik. Ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik "L." shpk ka paraqitur nje kontrate me shoqerine "K." ku i gjithe dokumentacioni bashkengjitur kontrates eshte teresisht i paqarte dhe i palexueshem, duke u bere i pamundur identifikimi i te dhenave te tij dhe verifikimi i tyre nese jane ne perputhje me kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit me qellim krijimin e nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesive te operatorit ekonomik per permbushjen me sukses te

kontrates.,

Sa më sipër, sqarojmë se është detyrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik për paraqitjen dhe hedhjen e dokumentacionit të plotë, të saktë e të qartë për nga mënyra e leximit dhe identifikimit të të dhënave të tij, në mënyrë që të jetë i lexueshëm dhe për të verifikuar nëse ai është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "L."shpk per kontraten e paraqitur me shoqerine "K." nuk mund te konsiderohet i vlefshem". Sa më sipër në të dy kontratat e paraqitura në plotësim të këtij kriteri për thertore nuk plotësojne kriteret e percaktuara nga AK në DST.

Nga auditimi dokumentacionit i administruar në dosjen e procedurës e pasqyruar në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se; oferta me vlerë më të ulët e konsideruar e pavlerësuar drejtësisht e vlerësojmë se kërkesat kualifikuese të dorëzuara nga ky OE janë të plotësuara dhe KVO-ja gjatë shqyrtimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit "oferta më e ulët" në procesin e vlerësimit duhej të kishte qënë më fleksibël për të kualifikuar edhe ofertën e dorëzuar nga OE "L."shpk me vlerë 3.165.600 lekë pa tvsh, si ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme dhe dokumentat e paraqitura në konkurim nuk kanë sjell asnjë deformim të ofertës, në përmbushje të detyrimeve të parashikuar nga neni 53 pika 1, ku citohet qartësishtë; "Autoriteti kontraktor kur e shikon të arsyeshme u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 e 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme"dhe neni 54 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pasi mangësitë e pa analizuara në vlerësimin e ofertës, pa cilësuar dhe pa cënuar thelbin e ofertës të parashikuara në LPP, ndërsa KVO-ja duhej të ishte kërkuar arsyetim me informacion shtesë nga ky OE konkurues me ofertë ekonomike më favorizuese sepse;
-për pikën 2, gërma (ç); "..konstatohet se për shlyerjen e detyrimit të energjisë është kërkuar vetëm; (Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri).....", ndërsa KVO ka kërkuar jashtë kësaj kërkese përfshirjen e muajit mars 2017, por ky komision mban 2 qëndrime të ndryshme për të njëjtën kërkesë kualifikuese, sepse oferta e paraqitur nga OE konkurues "G."shpk me vertëtimin e energjisë nr.307, datë 12.04.2017 është kualifikuar, ndërkohë që ka të njëtjën përmbajtje dhe datë"..., për pasojë oferta me këtë dokunement i dorëzuar në konkurim plotëson kërkesën kualifikuese.

-për pikën 1.3;"..konstatohet se, dokumentacioni për kompleksi stallor është paraqitur kontrata me shoqerine "Fogi"shpk e cila është kontratë me vulë të njomë të zyrës noteriale....", për pasojë oferta me këtë dokunement i dorëzuar në konkurim plotëson kërkesën kualifikuese.

-për pikën 1.3; ".....është e vërtet që dokumetacioni i objektit thertore është në kushtet e pa dukshme dhe për objektin tjetër thertore është e paisur me leje III.1.B, por është i paisur më leje nga Inspektoriati shtetror shëndëtsor, njëkohësisht referuar në Shtojca 19 Sasia dhe grafiku i lëvrimit ku sasia e mishit për tu furnizuar është vetëm 900 kg, kërkesa për kualifikuese që OE të ketë në pronësi apo me qera një objekt thertore me sipërfaqe jo më të vogël se 150 m2 është kërkesë e pa argumentuar.....", për pasojë kjo kërkesë duhet të konsiderohet devijim i vogël duje kërkuar edhe informacion shtesë për vlerësimin e kërkesës kualifikuese.

Në këto kushte vlerësimi bërë nga KVO për shpalljen e ofertës fituese, është në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", neni 20 "Mosdiskriminimi", neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", neni 52 "Hapja e ofertave" pika (1); (6), neni 53 "Shqyrtimi i ofetave", pika (1); neni 54 "Alternativat", neni 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu (VII) "Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave"; neni 64 "Hapja e ofertave"; neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"; neni 67 "Klasifikimi i ofertave"; neni 68 "Raporti përmbledhës"; neni 74 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pasi ka skualifikuar ofertën me vlerë më të ulët e cila plotëson kriteret për kualifikim, për pasojë vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertës fituese me vlerë 3.546.200 lekë pa tvsh me diferencë më tepër shuma 380,600 lekë pa tvsh (3546200-3165600) përbën efekt negativ finaciar për buxhetin Bashkia Tiranë duke mos siguruar efektivitetin e fondeve në shumën 380,600 lekë pa tvsh.
2-Në dokumantacionin e administruar në dosjen e sistemit të prokurimit elektronik në APP (Ref.57-002) për procedurën me objekt;" Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme" u konstatuan mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi konkretishtë;

	-Nëpërmjet njoftimit të fituesit datë 04.04.2018 konstatohet se, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE "K."shpk me vlerë 4,668,050 lekë pa tvsh, ndërsa nuk ka kualifikuar ofertën e paraqitur nga OE "L."shpk me vlerë 3,986,300 leke pa tvsh, njëkohësishtë edhe ofertën e paraqitur nga OE "D."shpk me vlerë 4,003,900 lekë pa tvsh edhe kjo vlera më e ulët se oferta e shpallur fituese me diferencë shuma 664,150 lekë pa tvsh. Nga auditimi dokumentacionit i administruar në dosjen e procedurës e pasqyruar në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se për këtë ofertë me vlerë më të ulët, KVO nuk e ka konsideruar në njoftimin dhe shpalljen e fituesit dhe nuk e ka shqyrtuar dhe vlerësuar me kërkesat kualifikuese të dorëzuara, ndërsa nga verifikimi i dokumentave të OE "D."shpk janë të plotësuara dhe KVO-ja gjatë shqyrtimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LPP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit "oferta më e ulët" në procesin e vlerësimit duhej të kishte qënë më fleksibël për të kualifikuar edhe ofertën e dorëzuar nga OE "D."shpk me vlerë 4,003,900 lekë pa tvsh, si ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme dhe dokumentat e paraqitura në konkurim nuk kanë sjell asnjë deformim të ofertës, në përmbushje të detyrimeve të parashikuar nga neni 53 pika 1, ku citohet qartësishtë; "Autoriteti kontraktor kur e shikon të arsyeshme u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 e 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme"dhe neni 54 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pasi mangësitë e pa analizuara në vlerësimin e ofertës, pa cilësuar dhe pa cënuar thelbin e ofertës të parashikuara në LPP, ndërsa KVO-ja duhej të ishte kërkuar arsyetim me informacion shtesë nga ky OE konkurues me ofertë ekonomike më favorizuese. Në këto kushte vlerësimi bërë nga KVO për shpalljen e ofertës fituese, është në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", neni 20 "Mosdiskriminimi", neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", neni 52 "Hapja e ofertave" pika (1); (6), neni 53 "Shqyrtimi i ofetave", pika (1); neni 54 "Alternativat", neni 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu (VII) "Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave"; neni 64 "Hapja e ofertave"; neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"; neni 67 "Klasifikimi i ofertave"; neni 68 "Raporti përmbledhës"; neni 74 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pasi ka skualifikuar ofertën me vlerë më të ulët e cila plotëson kriteret për kualifikim, për pasojë vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertës fituese me vlerë 4,668,050 lekë pa tvsh me diferencë më tepër shuma 664,150 lekë pa tvsh(4668050-4003900) përbën efekt negativ finaciar për buxhetin e Bashkisë Tiranë duke mos siguruar efektivitetin e fondeve në shumën 664,150 lekë pa tvsh. Për sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet për problematikat e trajtuara dhe qëndrimin strikt ndaj plotësimit të kritereve duke mos u udhëhequr nga qëllimi kryesor i prokurimit publik ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike, janë objekt i veprimtarisë së Njësisë së Prokurimit dhe KVO sipas rastit trajtuar në procedurat e mësipërme.
Kriteri:	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: - neni 46 - "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, ku thuhet: *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.* - neni 53 - "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku thuhet: *"3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, ...5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"; etj.*
Ndikimi/ Efekti:	Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, nuk jep garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke sjellë premisa të larta për përdorim të fondeve publike pa efektivitet.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave ligjore nga KVO për kualifikimin dhe s'kualifikimin e operatorve ekonomik.

Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eleminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST si dhe të mos mbaj qëndrim strikt duke konsideruar in ekstremis shmangie të cilat mund të konsiderohen se nuk cënojnë zbatimin e kontratës duke siguruar eficencën e përdorimit të fondeve publike..

V. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i kualifikuar mbi pasqyrat financiare
Për drejtimin e DSHKM në varësi të Bashkisë Tiranë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë, për vitin ushtrimor 2018 të cilat përfshijnë:

1. Pasqyrën e pozicionit financiar;
2. Pasqyrën e performancës financiare;
3. Pasqyrën e flukseve monetare;
4. Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
5. Pasqyrën mbi shënimet shpjeguese

Si dhe pasqyrat statistikore. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi sipas parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Veprimtaria është audituar sipas kërkesave të përputhjes me parimet e kontabilitetit të pranuara ligjit organik të buxhetit, si kërkesat: e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël "Kapitulli I, pika 1 dhe UMF nr.14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj" Kapitulli IV **"**Disa veçori për llogarite vjetore te njësive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj", ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 58,59 dhe 60 "Shërbimi i borxhit", me ligjin nr.9869 datë 04.02.2009 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore "neni 9 pikat 2,5; neni 2 pika 4; neni 12 pika 1; me ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 41 "Buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm" pika 2 nënpika (ç/iii).

Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për opinionin tonë.

Opinioni i kualifikuar[1]

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin e Kualifikuar", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2017, referuar Ligjit "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për Opinionin

[1] *Opinioni i kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë, për vitin ushtrimor, më 31 dhjetor 2018, e cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdoruesve të pasqyrave financiare.

Kemi konstatuar se në disa llogari të pasqyrave financiare, janë kryer veprime kontabël të gabuara duke natyruar përmbajtjen e tyre dhe duke pakësuar vlera kontabël, çka i bëjnë ato të pa sakta.

- Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera.
- Për vitin 2018, nga Drejtoria e Financës, *nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit* financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit.

Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së DPN2PQ, në varësi të Bashkisë Tiranë.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2018.

Opinion i kualifikuar.

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin e Kualifikuar", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

Baza për opinion e kualifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi.

Në DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar veprime që nuk përputhen me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në 1 procedurë të shoqëruar me shpenzime jo sipas 3-E në shumën 2,506,340 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë.
Drejtimi i DKSHM në varësi të Bashkisë Tiranë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

VI.REKOMANDIMET

Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa më sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe çeljen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyn pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.
(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për periudhën 2016 - 2018, u konstatua se mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj. Nëpunësi autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, në Bashki, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, aktivitetet dhe objektivat e realizuara për çdo projekt, të përcaktuara në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm", nga ku konstatojmë se ka mangësi për sa i takon analizës së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program. Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mos efektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë rriskuar dhe nxitur shkurtimin e mosrealizimin shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përllogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimin e tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.

(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim efiçient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë, për vitin 2018, nga Drejtoria e Financës nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit. Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme

(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim:

-njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit,
-programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe
-zvogëlimin e borxhit financiar.

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga testimi i funksionimit të kontrolleve të vendosura në kuadrin e menaxhimit financiar dhe kontrollit raportohet se strukturat drejtuese janë përfshirë në vendimmarrje në masën 100% të të intervistuarve; kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme rreth 80% e të intervistuarve; janë njohur me strategjitë e njësisë për periudhën 2018-2022 rreth 100% e të intervistuarve nga të cilët 80% raportojnë se strategjia është reflektuar tek

buxheti vjetor, 20% tek plani strategjik; në procesin e rekrutimit janë përfshirë 100% e drejtuesve dhe, pyetjes "Në cilën pjesë të analizës SËOT gjatë vitit 2018 keni kontribuar?" asnjë nuk ka qenë pjesë e analizës. Raportohet gjithashtu nga niveli i mesëm specialist se kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018 vetëm 33% e të intervistuarve dhe, pyetjes "A jeni njohur me strategjinë për vitin 2018?" raportojnë pozitivisht 95% e të intervistuarve. Gjithashtu pyetjes "Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018?" raportojnë 81% tek përshkimi i punës për çdo vend pune dhe 19% tek plani strategjik.
(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Drejtori i DKSHM të marrë masa me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.

Në vazhdimësi

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Në dokumentacionin e administruar në dosjen e sistemit të prokurimit elektronik në APP (Ref.57-002) për procedurën me objekt "Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme" dhe në dokumentacionin e administruar në dosjen e sistemit të prokurimit elektronik në APP (Ref.11-392) për procedurën me objekt;" Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme" u konstatuan mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi në procesin e vendimmarrjes së Autoritetit Kontraktor duke skualifikuar OE me kontratë më të favorshme si rezultat i qëndrimit strikt të plotësimit të kritereve për kualifikim ndërkohë që duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike në këtë procedurë mund të ishte kursyer shuma prej 1,044,750 lekë duke shkaktuar në këtë mënyrë mospërdorim me eficiencën e duhur të përdorimit të fondeve në shumën e mësipërme.
(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi Autoriteti kontraktor të shmang vlerësimet strikte dhe të udhëhiqet nga qëllimi kryesor i kuadrit rregullator në fuqi për prokurimin publik ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike duke vlerësuar devijime si të karakterit jo shumë material që nuk cenojnë zbatimin e kontratës pasi është në kufijtë që lejon ligji për devijime të vogla.

Në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT TË KLSH

A. Th.

B. M.

I. Sh.

J. L.

G. H.

A. Gj.

S. M.